



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 24/1 Prot.

Tiranë, më 27/04/2022

URDHËR

NR. 170, DATË 27/04/2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 2831/1, DATË 24.04.2015
“PËR MARRJEN NË DORËZIM TË AKTEVE NOTERIALE, REGJISTRAVE TË ISH-
NOTERES BLERINA KODRA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 4 dhe 67 pika 2 të Ligjit nr. 110/2018, “Për Noterinë”,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e pikës 2, të Urdhrit nr. 2831/1, datë 24.04.2015, si vijon:

Ngritja e Komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga 4 (katër) anëtarë.

Znj. Matilda Hoxha, Specialist në Sektorin e Veprimtarisë Noteriale;
Znj. Diana Toro, Specialist në Sektorin e Veprimtarisë Noteriale;
Z. Stavri Ruvina, Kryetar i Degës Vendore të noterisë Korçë;
Z. Fatmir Laçe, anëtar i Degës Vendore të noterisë Tiranë.

2. Ndryshimin e pikës 3, të Urdhrit nr. 2831/1, datë 24.04.2015, si vijon:

Arkiva t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noterit të Degës Vendore të Noterisë Korçë z. Josil P. Duro, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noteri plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësore të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

3. Ndryshimin e pikës 4, të Urdhrit 2831/1, datë 24.04.2015, si vijon:

Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterial noterit z. Josil P. Duro, të caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Korçë, si dhe kryen dhe asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, së ish-noteres Blerina Kodra.

4. Ndryshimin e pikës 6, të Urdhrit 2831/1, datë 24.04.2015, si vijon:

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, të marrë masat e nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës, si dhe ish-noteres Blerina Kodra.

5. Shtimin e pikës 7 në Urdhrin 2831/1, datë 24.04.2015, si vijon:

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të kryejë veprimet e nevojshme për të mbështetur kryerjen dhe marrjen në dorëzim të arkivit.

6. Shtimin e pikës 7 në Urdhrin 2831/1, datë 24.04.2015, si vijon:

Ngarkohet Sektori i Arkiv- Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI

ULSI MANJA

